

URDHËR
Nr. 663, datë 19.11.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.
2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 20.11.2020 deri në datën 25.11.2020.
3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.
5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido